Numër: 04/01 Datë: 05.01.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2025 merr:

V E N D I M

I. Riakreditohet dhe Rivalidohet "American Beauty School" Rruga " 12 qershori " Ferizaj Rruga " Idriz Seferi " Gjilan, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data: 09.05.2025 deri më 09.05.2030, me kualifikimin:

1. **Grimer/Grimere niveli III** Sipas Kornizës Kombëtare Të Kualifikimeve (KKK), me numër total të kredive 7, kualifikim i bazuar në: **Kualifikime Kombëtare Profesionale, (D).** 'American Beauty School'' për një vit kalendarik mund të certifikojë: në Ferizaj në max deri dyqind e dhjetë (210) kandidatë të ndarë në 7 grupe me dy ndërrime, max i kandidatëve për një grup duhet të jetë 15 kandidatë, po ashtu edhe në Gjilan mundë të certifikoj në max deri dyqind e dhjetë (210) kandidatë të ndarë në 7 grupe me dy ndërrime, max i kandidatëve për një grup duhet të jetë 15 kandidatë.

II. Riakreditohet dhe Rivalidohet "American Beauty School" Rruga " 12 qershori " Ferizaj Rruga " Idriz Seferi " Gjilan, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data: 28.12.2025 deri më 28.12.2030, me kualifikimin:

1. **Manykirst/Manykiriste niveli III** Sipas Kornizës Kombëtare Të Kualifikimeve (KKK), me numër total të kredive 5, kualifikim i bazuar në: **Kualifikime Kombëtare Profesionale, (D).** 'American Beauty School'' ABS për një vit kalendarik mund të certifikojë në Ferizaj në max deri dyqind e dyzet (240 kandidatë të ndarë në 10 grupe me

dy ndërrime, max i kandidatëve për një grup duhet të jetë 12 kandidatë, po ashtu edhe në Gjilan mundë të certifikoj në max deri dyqind e dyzet (240) kandidatë të ndarë në 10 grupe me dy ndërrime, max i kandidatëve për një grup duhet të jetë 12 kandidatë.

III. Riakreditohet dhe Rivalidohet "American Beauty School" Rruga " 12 qershori " Ferizaj Rruga " Idriz Seferi " Gjilan, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data: 22.03.2025 deri më 22.03.2030, me kualifikimin:

1. **Parukier/Parukiere niveli IV** Sipas Kornizës Kombëtare Të Kualifikimeve (KKK), me numër total të kredive 32, kualifikim i bazuar në: **Kualifikime Kombëtare Profesionale, (D).** ''American Beauty School'' për një vit kalendarik mund të certifikojë në Ferizaj në max deri nëntëdhjetë (90) kandidatë të ndarë në 3 grupe me dy ndërrime, max i kandidatëve për një grup duhet të jetë 15 kandidatë, po ashtu edhe në Gjilan mundë të certifikoj në max deri nëntëdhjetë (90) kandidatë të ndarë në 3 grupe me dy ndërrime, max i kandidatëve për një grup duhet të jetë 15 kandidatë. Kurse për certifikim të pjesshëm mundë të certifikoj deri në 10 grupe me nga 10 kandidatë në total 100 kandidatë brenda një viti.

II. Obligohet Institucioni të plotësoj kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

III. Institucioni mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit "American Beauty School", të parashtruar në AKK, për riakreditim dhe rivalidim të institucionit në qytetet Ferizaj dhe Gjilan, për kualifikimet:

1. **Grimer/Grimere niveli III**
2. **Manykirst/Manykiriste niveli III**

3. **Parukier/Parukiere niveli IV**

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për riakreditim dhe rivalidim për kualifikimet si më lartë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 11.10.2025 për kualifikimin: **1.Grimer/Grimere niveli III** ndërsa vizita Ferizaj është realizuar me datën *16.10.2025* dhe ne Gjilan 17.10.2025 . Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë 29.10.2025. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 22.12.2025.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 10.10.2025 për kualifikimin: **Manykirst/Manykiriste niveli III** ndërsa vizita Ferizaj është realizuar me datën *16.10.2025* dhe ne Gjilan 17.10.2025 . Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë 30.10.2025. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 22.12.2025.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 09.10.2025 për kualifikimin: **Parukier/Parukiere niveli IV** ndërsa vizita Ferizaj është realizuar me datën *16.10.2025* dhe ne Gjilan 17.10.2025 . Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë 28.10.2025. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 22.12.2025.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave së realizuar tek pala aplikuese.

AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

- Institucioni "American Beauty School ",
- Arkivit të AKK.